



*Enhancing knowledge of EU green finance
policies in insurance and business valuation
- Green FIB-*

*Intensive Course
Green Finance & Sustainability*



**Co-funded by
the European Union**





Green FIB



Co-funded by the
European Union

Green Insurance

Sigurimi i gjelbër

Lecturer: Anila Hoxha

Director of Albanian Insurance Bureau

Background



Ndryshimet klimatike kanë sjellë një ndikim të jashtëzakonshëm për jetën në planetin tonë duke e ballafaquar atë me një rrezik ekzistencial. Kjo ka bërë që organizata ndërkombëtare, shtete dhe institucione të ndryshme të përpunojnë politika që kërkojnë të ndryshojnë në mënyrë radikale qëndrimin tonë ndaj mjedisit.

Komisioni Evropian, në dhjetor të vitit 2019 prezantoi iniciativën, e njohur si European Green Deal, një strategji që nxit investimet publike dhe private në projekte të qëndrueshme dhe që synon ta bëjë Europën kontinentin e parë neutral ndaj klimës dhe me emetim zero deri në vitin 2050



Green FIB



Co-funded by the
European Union

Hyrje

Ndryshimet klimatike

- Shkaqet - Gazrat serë
- Risqet dhe pasojat - Katastrofat natyrore

Rritja e përqendrimit të gazrave serë

- ▶ dioksidi i karbonit (CO₂)
- ▶ metani
- ▶ oksidi i azotit
- ▶ gazrat e fluorizuar

Burimet kryesore

- ▶ Karburantet fosile
- ▶ Prodhimi i energjisë dhe nxehtësisë
- ▶ Makinat dhe aeroplanët
- ▶ Ndërtimi banesave
- ▶ Ndërtimi i rrugëve
- ▶ Plastika
- ▶ Industria
- ▶ Gazet e fluorizuara (gazet frigoriferikë)
- ▶ Fermat blegtorale
- ▶ Industria ushqimore
- ▶ Fertilizuesit
- ▶ Landfillet
- ▶ Shpyllëzimet
- ▶ Konsumi tepërt
- ▶ Shkaqe natyrore

Katastrofat natyrore dhe jeta e gjallë.

Disa nga pasojat janë

- ▶ temperatura më të larta. Rritja e përqendrimit të gazrave serë sjell rritjen globale të temperaturave,
- ▶ stuhi më të rënda,
- ▶ zjarre,
- ▶ thatësi e rritur,
- ▶ rritje e temperaturave të oqeanëve,
- ▶ humbje e specieve,
- ▶ pamjaftueshmëri ushqimore,
- ▶ rreziqe shëndetësore,
- ▶ varfëri dhe lëvizje demografike.

Çfarë është “Sigurimi i gjelbër” (Green Insurance)



Sigurimi i gjelbër është një koncept i lidhur me sigurimet që kanë për qëllim të përmirësojnë sjelljen ndaj mjedisit dhe të promovojnë praktika të qëndrueshme. Këto lloje sigurimi janë një pjesë e përpjekjeve për të zvogëluar ndikimin negativ të industrive dhe individëve në mjedis dhe për të inkurajuar sjellje të përgjegjshme ndaj natyrës.

Përfitime të tjera



- ▶ Përshtatja me praktikat që janë të njohura si të sigurta për mjedisin ose "të gjelbërta", mund t'ju ndihmojë gjithashtu të kurseni në shpenzimet tuaja të sigurimit. Si në rastin kur jeni duke konsideruar sigurimin e një makine eko-miqësore, sigurim më të përballueshëm për shtëpinë ose sigurimin kur jeni duke adoptuar praktika "të gjelbra" të biznesit, ofrohen modele propozimesh (iniciativash) të përfitimeve të sigurimit për produktet me përgjegjshmëri për mjedisin.

Iniciativat e nxitjes së sigurimit të gjelbër për automjetet motorike

Lëndët djegëse fosile shterojnë burimet tona dhe të kontribuojnë në ndotjen e mjedisit dhe ka kompani sigurimi që ofrojnë zbritje për automjetet që nuk i përdorin ato.

- ▶ Ulje Premium për Automjetet hibride
- ▶ Inkurajimi i iniciativave mbështetëse që lejojnë zëvendësimin hibrid
- ▶ Zbritje Premium për karburantet alternative
- ▶ Programe Paguaj sa udhëton (PAYD)



▶ **Ulje Premium për Automjetet hibride**

Ofrohen nga kompani të sigurimit (dhe zbritje të ngjashme mund të jetë ofrohen gjithashtu për sigurimin e mjetve lundruese hibride elektrike anije dhe jahte).

▶ **Inkurajimi i iniciativave mbështetëse që lejojnë zëvendësimin hibrid**

Mund të jetë, opsion mbulimi pas një humbje totale të makinës, i siguruari mund të zëvendësojë automjetin e tij tradicional me një automjet të krahasueshëm hibrid.

▶ **Zbritje Premium për karburantet alternative**

Zbatohen nëse makina juaj përdor një burim të energjisë alternative të tilla si bionaftë, energji elektrike, gaz natyror, hidrogjen ose etanol.

▶ **Programi Paguaj sa udhëton (PAYD)**

Program që cilat kërkojnë instalimin e një pajisje për të ndjekur kilometrat e përshkuara nga makina tuaj. PAYD ofron politika zbritje për shoferët sipas të cilës sensori, tregon se makina ka përshkuar më pak kilometra se mesatarja—duke i kursyer konsumatorit para dhe duke reduktuar aksidentet, bllokimet dhe ndotjen e ajrit.



Co-funded by the
European Union

Sigurimi i gjelbër për banesën

Siguruesit janë duke ndihmuar për zhvillimin e qëndrueshëm të praktikave të ndërtimit duke ofruar politika miqësore ndaj mjedisit për pronarët e shtëpive, të cilat përfshijnë opsione të tilla si:

- ▶ Zbritje Premium për shtëpitë e certifikuar LEED
- ▶ Miratimin e zëvendësimit të materialeve miqësore ndaj mjedisit
- ▶ Përfshirje më e gjerë në burimet alternative të energjisë



- ▶ Zbritje Premium për shtëpitë e certifikuar LEED

LEED është akronim për (Leadership in Energy and Environmental Design Green Building Rating System) Sistemin e Klasifikimit për Orientim në Projektim për Energjinë dhe Mjedisin e një Ndërtimi të Gjelbër.

- ▶ Miratimin e zëvendësimit të materialeve miqësore ndaj mjedisit

Politika të cilat janë ofrohen si politika standarde për pronarët e shtëpive. Për shembull, disa kompani mund tu paguajnë pronarëve të shtëpive shtesë nëse ata do të riciklonin mbetjet në vend që ti dërgonin për tu shkatërruar në landfill, dhe të zëvendësojnë pajisjet e vjetra jo ekonomike me pajisje me konsum të ulët, që plotësojnë standardet më të mira evropiane për kursimin e energjisë.

- ▶ **Përfshirje më e gjerë në burimet alternative të energjisë**

Për pronarët e shtëpive që të gjenerojnë vetë energjinë gjeotermale, diellore ose energjinë e erës dhe të shesin ndonjë tepricë të energjisë përsëri në rrjetin lokale të energjisë, ofrohen politika që mbulojnë të dy shpenzimet shtesë blerjen e përkohshme të energjisë elektrike nga një burim tjetër, si dhe për të ardhurat e humbura gjatë një ndërprerje të energjisë (për aq kohë sa ndërprerje është shkaktuar nga një rrezik mbuluara nga sigurimi). Politikat që në përgjithësi mbulojnë koston për të kthyer online, pajisje të tilla si pagesat për inspektim dhe ri-lidhje.

Sigurimi i gjelbër për biznesin



Ka shumë politika sigurimi të gjelbra të pronës tregtare, dhe rregullime me objekt segmente të veçanta të komunitetit të biznesit të tilla si prodhuesit.

- ▶ Mbulimi i instalimit të sistemeve "të gjelbra" në ndërtesa dhe materiale. për të zëvendësuar ato standarde, pas një humbje
- ▶ Të lejojë rindërtimin e certifikuar "i gjelbër" në rast të një humbje të plotë



- ▶ Mbulimi i instalimit të sistemeve "të gjelbra" në ndërtesa dhe materiale. për të zëvendësuar ato standarde, pas një humbje

Këto zëvendësime miqësore ndaj ambientit do të përfshijë pajisje efikase të energjisë elektrike për ndriçimin, instalime hidraulike për ruajtjen e ujit dhe, bojëra jo toksike të drurit.

- ▶ Të lejojë rindërtimin e certifikuar "i gjelbër" në rast të një humbje të plotë

Përveç vetë ndërtimit, ky mbulim të mund të paguajë për inspektimet inxhinierike të ngrohjes, ventilimit, sistemet me ajër të kondicionuar, tarifat certifikimit të ndërtimit, zëvendësimin çative të mbuluara me vegetacion apo bimë, me, riciklimin e mbeturinave dhe humbjen e të ardhurave dhe shpenzimet e bëra gjatë kohës kur rezultojnë të dëmtuara pajisjet për gjenerimin e të energjisë alternative.



Green FIB



Co-funded by the
European Union

FALEMINDERIT